Nr.2463 Prot Data.25.06.2026

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Këshilli Bashkiak Devoll në bashkëpunim me Ekzekutivin, organizon konsultim publik për "Draftin e Planit Social 2027 – 2030". Propozuesi i projektaktit: Drejtoria e Sherbimit Social

Qëllimi: Ky konsultim me banorët dhe grupet e synuara të Bashkisë Devoll ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me " Draft Planin Social 2027 – 2030".

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin/grupet e interesit do të zhvillohet në Bashkine Devoll, Salla e Këshillit Bashkiak, sipas informacionit më poshtë:

Data 14.07.2026 Ora:11:00 Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak, Bashkia Devoll

Gjithashtu, sugjerimet tuaja, të nderuar banorë të bashkisë Devoll, janë të mirëpritura, në adresen e e-mail:

zerina.sinani@yahoo.com

braholli3dina@gmail.com

Draft "Plani Social 2027– 2030"e gjeni në linkun: https://bashkiadevoll.gov.al/wp-content/uploads/2026/06/Plani-Social-Bashkia-Devoll-Draft-date-25-qershor-2026-FINAL.pdf

ne link ku mund te aksesohet draft plani.

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Komisioni i ceshtjeve sociale ne KB Devoll, Perfaqesuese te aleances se grave keshilltare te KB Devoll, Përfaqësues të administratës së bashkisë, perfaqesues si dhe koordinatori për konsultimin publik në bashkinë Devoll,
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Devoll, grupe interesi, Organizata të shoqërisë civile që funksionojnë në Devoll, përfaqësues nga Këshilli i Qarkut Korçë, Përfaqësues të institucioneve të dekoncentruara që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bashkinë Devoll, etj.

Forma e konsultimit: Takim i drejtpërdrejtë, sugjerime përmes e mailit.

Qëllimi i këshillimit publik	Diskutimi dhe mbledhja e rekomandimeve per "Draft Planin Social 2027–2030".
Përshkrimi i çështjes	Draft Plani Social 2027 - 2030 u përgatit nga Bashkia Devoll, si mjeti kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për sherbimet sociale, të ndërmarra nëpërmjet zbatimit te detyrimeve ligjore ne fuqi. Draft Plani Social 2027– 2030, u hartua përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me të gjitha drejtoritë e bashkisë, njësitë administrative, institucionet publike vendore, Aleancën e Grave Këshilltare dhe anëtare e anëtarë të Këshillit Bashkiak. Të gjitha masat

	dhe veprimet e paraqitura si pjesë e ketij plani 2027 - 2030, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Ky draft Plan Social eshte hartuar me ndihmen e ekspertes se kontraktuar nga UNDP. Hartimi i ketij Plani Social eshte i lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit përkatës dhe dokumentet kryesorë ku mbështeten hapat e planifikuar.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresen zerina.sinani@yahoo.com braholli3dina@gmail.com brenda dates **13.07.2026**
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet qe do të ndërmarrë Këshilli dhe adiministrata për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë dhe Bashkia Devoll do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh nese do te kete Kryetarit të Bashkisë dhe Komisionit te ceshtjeve sociale ne KB Devoll, dhe Drejtorise se Sherbimit Social. 3. Shqyrtimi nga ana e Komisionit te ceshtjeve sociale te KB Devoll, të cdo rekomandimi dhe opinioni. 4. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 5. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar. 6. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	**Data: 25.06.2026**

Drejtor i Sherbimit Social

Zerina Sinani